



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.215/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Skender Çoçaj kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Koalicija Vakati, kandidati (Usmen Baldzi) me seli në Dragash, paraqitur kundër Anëtarëve të KVV-së në fshatin Restelicë, komuna Dragash, për shkak të presionit ndaj votuesve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më 15.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.215/2025, e datës 14.10.2025, nga subjekti politik, Koalicija Vakati, kandidati (Usmen Baldzi) me seli në Dragash, paraqitur kundër Anëtarëve të KVV-së në fshatin Restelicë.

A r s y e t i m

Me datë 14.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e subjektit politik Koalicija Vakati, me të cilën pretendohet se në fshatin Restelica, janë vërejtur shumë parregullësi. Votimi ishte zhvilluar pa mbikëqyrje serioze, madje edhe në mënyrë kaotike. Duke i shqyrtuar kamerat, mund të shihet se asistentët ishin të njëjtit persona, ata që sillnin votuesit dhe asistonin njërit, pastaj tjetrit, dhe kështu gjatë gjithë ditës. Brenda shkollës po kryhej mobbing, po kërcënohej dhe brenda shkollës votuesit merreshin në mënyrë që të votohet në emër të tyre dhe kjo mund të shihet duke shqyrtuar kamerat e mbikëqyrjes.

Me tutje në ankesë theksohet se bazuar në ankesat e votuesve që ishin ankuar, disa nga vëzhguesit në një moment të caktuar kryenin funksione të anëtarëve të komisioneve zgjedhore, duke kontrolluar kartat e identitetit, ose duke kontrolluar dokumentet.

Nga Ju, kërkojmë që duke shqyrtuar regjistrimet, të shihni asistencat e shumëfishta dhe të tjera të përmendura dhe në bazë të kësaj të merrni një vendim për përgjegjësinë e menaxherit të shkollës, të kryetarëve të vendvotimeve dhe të gjithë atyre që kanë kontribuar me manipulime dhe kërcënime në votim në mënyrë të tillë që shumë nuk kanë votuar lirshëm dhe vetë për vete.

Në një vendvotim, në kabinën e votimit, u gjet material jo-zgjedhor me faqe të hapura të subjekteve politike, ku ishte rrethuar numri 183. Në një kabinë tjetër ishte e hapur faqja e kandidatit të LDK-së, me numrin 2 tashmë të rrethuar. Parregullsitë e tilla tregojnë qartë një

përpjekje për të ndikuar në vullnetin e votuesve dhe përfaqësojnë shkelje serioze të procesit zgjedhor.

Provë: Fotografi të bashkangjitura

Në përgjigjen në ankesë të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve – KQZ, theksojnë se pretendimet e palës ankuese janë të përgjithshme, të mbështetura pa asnjë provë, jo të konkretizuara, të pa specifikuara për parregullsitë, nga kush është ushtruar kanosje, në cilin vendvotim është votuar në emër të personave të tjerë, ku janë përfshirë vëzhguesit në kryerjen e detyrave të anëtarëve të Këshillave të vendvotimeve (KVV) dhe në cilën vendvotim është gjetur material zgjedhor për të cilin pretendon se ka qenë i rrethuar numri për një subjekt politik. KQZ, pas pranimit të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunës së Dragashit, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim: KKZ, nuk ka pranuar asnjë raport, informatë, apo shprehje të pakënaqësive eventuale as në ditën e zgjedhjeve, as pas ditës së zgjedhjeve as në procesin e fillimit të numërimit të votave për Kryetar të komunave dhe subjekteve politike dhe se për këtë KKZ nuk ka hasur në asnjë provë apo dëshmi eventuale për apo lidhur me pretendimet e palës ankuese. Ky proces ishte vëzhguar nga vëzhguesit e partive politike po ashtu edhe nga vëzhguesit, ku nuk kemi pas as vërejtje më të vogël nga ana e tyre, sepse procesi ka qenë i rregullt dhe transparent. Nga librat e votimit nuk kishte ndonjë shënim që pretendon një gjë të tillë nga pala ankuese, dhe se në secilin vendvotim ekzistojnë kamerat. Vlen të cekët se në Librin e votimit të vendvotimit 0503/06 në Restelicë shënon se kryesuesi ka asistuar për Dzelil Toro në të njëjtin vendvotim ku ka qenë kryesues. Me tutje në përgjigje në ankesë theksohet se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, momentalisht gjendet në QKN të komunës së Dragashit, mirëpo pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve-QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organët e Drejtësisë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP në rastin konkret mori parasyshë përgjigjen në ankesë të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve – KQZ, ku kanë theksojnë se pretendimet e palës ankuese janë të përgjithshme, të mbështetura pa asnjë provë, jo të konkretizuara, të pa specifikuara për parregullsitë, nga kush është ushtruar kanosje, në cilin vendvotim është votuar në emër të personave të tjerë, ku janë përfshirë vëzhguesit në kryerjen e detyrave të anëtarëve të Këshillave të vendvotimeve (KVV) dhe në cilën vendvotim është gjetur material zgjedhor për të cilin pretendon se ka qenë i rrethuar numri për një subjekt politik. Po ashtu është nga përgjigjet dhe sqarimet e KKZ të komunës së Dragashit, është konstatuar se nuk ka pranuar asnjë raport, informatë, apo shprehje të pakënaqësive eventuale as në ditën e zgjedhjeve, as pas ditës së zgjedhjeve as në procesin e fillimit të numërimit të votave për Kryetar të komunave dhe subjekteve politike dhe se për këtë KKZ nuk ka hasur në asnjë provë apo dëshmi eventuale për apo lidhur me pretendimet e palës ankuese. Ky proces ishte vëzhguar nga vëzhguesit e partive politike po ashtu edhe nga vëzhguesit, ku nuk kemi pas as vërejtje më të vogël nga ana e tyre, sepse

procesi ka qenë i rregullt dhe transparent. Nga librat e votimit nuk kishte ndonjë shënim që pretendon një gjë të tillë nga pala ankuese, dhe se në secilin vendvotim ekzistojnë kamerat.

Në këto rrethana si dhe fakti se sipas përgjigjes së KQZ i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, momentalisht gjendet në QKN të komunës së Dragashit, mirëpo pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve-QNR, ndërsa nga provat që gjenden në shkresat e lëndës parashtruesi i ankesës nuk i ka mbështetur me prova pretendimet e tij Paneli konstatoi se nuk ka prova bindëse për tu konstatuar shkelja eventuale e pretenduar nga ankuesi.

Kështu që paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar kanë ndihmuar në asistimin në vendvotim, konkretisht nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.215/2025 më datën 15.10.2025.

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.